URDHËR
Nr.350, datë 28.5.2009

PËR "APLIKIMIN E SHTETASVE SHQIPTARE TË CILËT DISPONOJNË PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT PËR PAJISJE ME LETËRNJOFTIM ELEKTRONIK"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.9972, datë 28.07.2008 "Për ratifikimin e "Kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike" ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve"",

URDHËROJ:

1. Asnjë shtetas shqiptar i cili disponon pasaportë për jashtë shtetit, nuk do të lejohet të aplikojë për pajisje me letërnjoftim elektronik, mbas datës 30 maj 2009.
2. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile do të punojnë gjatë të shtatë ditëve të javës.
3. Orari i punës për zyrat e gjendjes civile do të jetë nga ora 08.^{oo} deri 13.^{oo} dhe 17.^{oo} deri 21.^{oo}, për të gjitha ditët e javës.
4. Çdo veprim i cili bie në kundërshtim me zbatimin e këtij urdhri, do të konsiderohet kundërvajtje administrative dhe do të ndëshkohet sipas dispozitave ligjore.
5. Ngarkohen me zbatimin dhe ndjekjen e këtij urdhri prefektët, njësitë e qeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani